



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME
PROKURORI I PËRGJITHSHËM

URDHËR

Nr. 322, Datë 22.12.2016

“PËR MIRATIMIN E FORMULARIT TIP PËR DHËNIEN E
INFORMACIONIT MBI TË AFËRMIT”

Në mbështetje të nenit 148/b shkronja “dh” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 279 pika 2 dhe 108 pika 3 shkronja “e” të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e formularit “Për dhënie e informacionit mbi të afërmit e shkallës së dytë, ungj/emtë, nip/mbesë, gjysh/gjyshe, gjysmë vëlla/motër dhe të afërmit e shkallës së parë të bashkëshortit/bashkëjetuesit, prindër, fëmijë dhe vëllezër/motra që ushtrojnë në mënyrë aktive profesionin e avokatit ose janë pronarë ose drejtues ekzekutivë në subjektet ekonomike, të cilat klasifikohen si tatimpagues të mëdhenj nga autoriteti tatimor”, sipas modelit bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Ngarkohet Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit për të siguruar publikimin e këtij urdhëri në faqen zyrtare të internetit të Prokurorisë së Përgjithshme.
3. Të njihen me këtë urdhër të gjithë prokurorët.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

PROKURORI I PËRGJITHSHËM

ADRIATIK LLALLA



FORMULAR

PËR DHËNIEN E INFORMACIONIT

Mbi të afërmit e shkallës së dytë, ungj/emtë, nip/mbesë, gjysh/gjyshe, gjysmë vëlla/motër dhe të afërmit e shkallës së parë të bashkëshortit/bashkëjetuesit, prindër, fëmijë dhe vëllezër/motra që ushtrojnë në mënyrë aktive profesionin e avokatit ose janë pronarë ose drejtues ekzekutivë në subjektet ekonomike, të cilat klasifikohen si tatimpagues të mëdhenj nga autoriteti tatimor.

(Plotësohet nga prokurori që konkuron për anëtar të Këshillit të Lartë të Prokurorisë në zbatim të ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”)

I. Të dhënat e Prokurorit që konkuron për anëtar të Këshillit të Lartë të Prokurorisë:

Emri Atësia Mbiemri: _____

Datëlindja: _____

Prokuroria: _____

II. A ushtron në mënyrë aktive profesionin e avokatit ndonjë i afërm i juaji i shkallës së dytë, (ungj/emtë, nip/mbesë, gjysh/gjyshe, gjysmë vëlla/motër)? (Vendosni shenjën X përbri përgjigjes)

PO / JO

(Nëse përgjigjeni PO, specifikoni në mënyrë të detajuar të dhëna për personin dhe aktivitetin që ushtron):

III. A është pronar ose drejtues ekzekutivë në subjektet ekonomike, të cilat klasifikohen si tatimpagues të mëdhenj nga autoriteti tatimor, ndonjë i afërm i juaji i shkallës së dytë, (ungj/emtë, nip/mbesë, gjysh/gjyshe, gjysmë vëlla/motër)? (Vendosni shenjën X përbri përgjigjes)

PO / JO

(Nëse përgjigjeni PO, specifikoni në mënyrë të detajuar të dhëna për personin dhe aktivitetin që ushtron):

- IV. A ushtron në mënyrë aktive profesionin e avokatit ndonjë i afërm i shkallës së parë, (prindër, fëmijë dhe vëllezër/motra) i bashkëshortit/bashkëjetuesit tuaj, z/znj. _____? (Vendosni shenjën X përbri përgjigjes)

PO / JO

(Nëse përgjigjeni PO, specifikoni në mënyrë të detajuar të dhëna për personin dhe aktivitetin që ushtron):

- V. A është pronar ose drejtues ekzekutivë në subjektet ekonomike, të cilat klasifikohen si tatimpagues të mëdhenj nga autoriteti tatimor ndonjë i afërm i shkallës së parë (prindër, fëmijë dhe vëllezër/motra) i bashkëshortit/bashkëjetuesit tuaj z/znj. _____? (Vendosni shenjën X përbri përgjigjes)

PO / JO

(Nëse përgjigjeni PO, specifikoni në mënyrë të detajuar të dhëna për personin dhe aktivitetin që ushtron):

Unë, i/e nënshkruari/a _____, me nënshkrimin e këtij formulari konfirmoj nën përgjegjësinë time saktësinë e të dhënave të pasqyruara.

Datë ___ / ___ / ___

(EMRI MBIEMRI)

(nënshkrimi)